



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .04.2025

**MBLEDHJA Nr. 19,  
Datë 24.04.2025, ora 12:30  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 24.04.2025, ora 12:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 14.04.2025.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GreenNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2024.
9. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.04.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW”.
10. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 233, datë 19.07.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

11. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

12. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**